



PËR: Komitetin për Politikë dhe Financa, Kryesuesin, z. Haxhi Ibishi;

NGA: Kryetari i Komunës së Klinës, z. Sokol Bashota;

SHTOJÇË: Procesverbali i takimit publik, 01Nr.020-5516/2014 i dt.29/12/2014;

LËNDA: Shkresë percjellëse, sipas të cilës KPF-ja duke u bazuar në nenin 25 të Statutit të Komunës, duhet që të bëj shqyrtimin e Procesverbalit lidhur me Takimin Publik, të mbajtur më datën 29/12/2014;

I nderuari kryesues dhe anëtare të Komitetit për Politike dhe Financa, përmes kësaj shkrese ju rikujtojmë se në harmoni me dispozitat e nenit 25 të Statutit të Komunës së Klinës, të dt.31.03.2010, Komiteti për Politike dhe Financa brenda afatit prej 60 ditësh nga mbajtja e takimit publik bënë shqyrtimin e procesverbalit lidhur me takimin publik, e i cili takim është mbajtur më dt.29/12/2014, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës.

Komiteti në seancën e dytë të radhës për vitin 2015, në përputhje me dispozitat e Statutit të Komunës, duhet të bën shqyrtimin e procesverbalit dhe shqyrton secilin propozim të dhënë nga qytetarët gjatë takimit më publikun, si dhe bënë rekomandimet e nevojshme për në seancën e ardhshme të Kuvendit të Komunës.

Me respekt,

01Nr. 06-800 /2015
Klinë, dt.04/02/2015



KUVENDI I KOMUNËS KLINË

Shërbimi për punë të Kuvendit

01 Nr. 020-5516 /14

Klinë me 29.12.2014

EKSTRAKT-PROCESVERBAL

Nga **TAKIMI ME PUBLIKUN** i mbajtur me datën **29. 12. 2014** në sallën e Kuvendit të Komunës me fillim në orën **13:00**.

Rendi i ditës:

1. **Rrjedhat e qeverisjes në Komunë në gjashtëmujorin e II-te të vitit 2014, të arriturat, synimet si dhe investimet kapitale,**
2. **Të ndryshme.**

Në këtë takim ishin prezent:

1. **Sokol Bashota.....Kryetar i Komunës**
2. **Dr. Haxhi Ibishi..... Kryesues i Kuvendit**
3. **Enver Berisha.....Nënkryetar i Komunës**

Pjesëmarrës të tjerë ishin: Përfaqësues të zyrës Ligjore të Komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, mediet, drejtorët e drejtorive Komunale si dhe një numër i konsiderueshëm i publikut.

Mbledhjen e hapi Kryetari i Komunës **z.Sokol Bashota** i cili pasi i përshëndeti të gjithë të pranishmit tha së në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale jemi të obliguar që ta mbajmë takimin e dytë me publikun për ti prezantuar Rrjedhat e qeverisjes në Komunën e Klinës në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2014 ndërsa për gjashtëmujorin e parë takimi me publikun është mbajtur me datën 30. 06. 2014, siç po shihet sot pjesëmarrja e publikut nuk është e kënaqshme por ndoshta ka ndikuar moti i ligë e reshjet mëdha të borës.

Gjatë këtij viti kemi investuar ne infrastrukturë rrugore siç janë asfaltimi i rrugës në fshatin Resnik, asfaltimi i dy rrugëve lokale në fshatin Krushevë e Vogël, asfaltimi i rrugës në fshatin Rudicë, rregullimi i rrugës Renovc-Leskocv, rregullimi i rrugës në Lagjen Perlina, ndërtimi i shkollës në fshatin Perqevë, ndërtimi i shkollës në Jashanicë , pastaj janë mbështetur segmentet në bujqësi, investime ka pasur në

tenda për ujitje siç është ajo në fshatin Krushevë e Madhe, kemi vazhduar me trajtimin e ujërave të zeza e kanë mbetur edhe një numër i vogël i fshatrave pa këto kanalizime. Përmes asfaltimit të rrugës Sferk- Bubel e kemi lidhur atë anë me Komunën e Malishevës, pastaj me asfaltimin e rrugës Caravik-Murg e kemi lidhur edhe atë rajon me Komunën e Skenderajt e shumë punë të tjera. Do të vazhdojmë me projektin e familjeve të dëshmorëve, pastaj do të ndërtohet një çerdhe e fëmijëve e vlera e sajë do të jetë rreth 350 mijë euro, e kjo çerdhe pritet të përfundojë në muajin shtator 2015, e për këtë çerdhe kemi një donacion nga Bashkimi Evropian në shumë prej 153 mijë euro, e po ashtu kemi edhe një premtim të donacionit nga BE-ja për thertoren në fshatin Videjë që do tmerret me kultivimin e mishit. Ne do të vazhdojmë me projekte të tjera vitin e ardhshëm, pastaj do të vazhdojmë me infrastrukturë rrugore, do ti shohim mundësit e vendosjes së kamerave edhe në pjesë të tjera të qytetit, pastaj do të vazhdojmë me projektet në sferën e bujqësisë ndërsa sa i përket fabrikës së ujit janë paraparë edhe disa punë shtesë për shkak të frikës së ndotjes nga ujërat e zeza dhe shumë shpejt do të lëshohet në përdorim.

Nëse ka dikush ndonjë pyetje jeni të lirë të bashkëbisedojmë për çdo problem që keni.

Sejdi Baleci nga fshati Grabanicë tha së unë Ju përgëzoi për punën që e keni bërë deri me tani, brenga ime është për disa projekte që kanë filluar e ende nuk janë përfunduar, Ne në fshat jemi duke e përgatitur një projekt për kanalin e ujitjes e hyrja është rreth 12 hektar, mandej për rrugë dhe ujë të pijes jemi shumë keq, edhe shkolla nuk është në gjendje të mirë është e nevojshme që të ndërrohen dyert dhe dritaret e sajë.

Sadik Elezaj nga Gjurgjeviku i Vogël pyeti për projektin e ujërave të zeza për këtë fshat së a do të jetë në projektet me prioritet për vitin 2015?

Sokol Bashota tha së projektet janë miratuar në kuvend ne do ti shohim mundësit tona si dhe të shohim sa do të jenë grandet nga Qeveria e Kosovës.

Sadik Elezaj tha së në projekt është paraparë një impiant për ujera të zeza.

Sokol Bashota tha së të gjitha problemet duhet të shtrohen në këso takimesh që ne i organizojmë dhe shpresojmë së në takimet e ardhshme do të kemi një prezencë me të madhe të publikut.

Unë Ju falënderoi të gjithëve për kontributin tuaj në këtë takim dhe Ju uroi festat e fundvitit.

Me kaq takim me publikun përfundoi ne orën 14:00.

Procesmbajtësi,
Beqir Gashi



Kryesuesi i TAKIMIT,
Sokol Bashota